

**DEKLARATË E NËNSHKRUAR NGA NJË PJESEMARRËS NË QMV
PAS VIZITËS NË QENDRËN E MËSIMIT VETJAK
OSE ME TË CILËN JANË INFORMUAR PËRMES TELEFONIT**

Unë, i nënshkruari _____ përmes kësaj konfirmoj me nënshkrimin tim se jam informuar se _____ (emri i Qendrës së Mësimi Vetjak (QMV), emri i organizatës suaj) ruan dhe përpunon të dhënat e mia personale (emrin dhe mbiemrin, adresën e banimit, numrin e telefonit, gjininë, moshën, nivelin dhe llojin e arsimit të kryer, distancën e banesës sime nga QMV) për qëllime zhvillimi, shkencore dhe kërkimi si edhe për qëllime të raportimit të njësia që financon aktivitetin. Konfirmoj më tej se jam informuar rreth politikës së mbrojtjes së të dhënave personale që aplikohet te kontrolluesi dhe që jepet në pjesën e pasme të kësaj deklarate, si edhe në uebsajtin www.acs.si.

Kontrolluesi i sistemit të arkivimit të të dhënave personale është Instituti Sloven për Arsimin e Të rriturve, ku këto të dhëna përpunohen për qëllime të implementimit të QMV nga _____ (emri i organizatës suaj), adresa: _____.

Të dhënat e mia personale do t'u komunikohen palëve të treta në mënyrë të anonimizuar, që do të thotë se identiteti im nuk do të jetë i dallueshëm prej të dhënave. _____ (emri i organizatës suaj) do t'i trajtojë të dhënat e komunikuar në përputhje me legjislacionin sloven që drejton mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligjin e Bashkimit Evropian.

Nënshkrimi:

MIRATIMI PËR NJOFTIMET RRETH AKTIVITETEVE TË QMV

Duke vendosur nënshkrimin tim, unë njëkohësisht pranoj që _____ (emri i organizatës suaj) të më njoftojë rreth aktiviteteve të QMV me:

- email: PO JO
- telefon: PO JO
- SMS: PO JO
- postë normale: PO JO
- në internet dhe/ose në aplikacionin për celular të organizatës (nëse keni një aplikacion të tillë, shënojeni atë): _____
 PO JO

Miratimi për njoftimet mbi aktivitetet QMV është vullnetar, dhe ju keni gjithashtu opsionin ta refuzoni ose ta tërhiqni atë.

Nënshkrimi:

MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Në përputhje me legjislacionin slloven në fuqi (Ligji për Mbrojtjen e Të dhënave Personale – ZVOP-1) dhe Rregullorja e re e Përgjithshme e Mbrojtjes së Të dhënave personale, ju do të keni të drejtat e mëposhtme në lidhje me mbrojtjen e të dhënave tuaja personale:

E drejta për akses te të dhënat

Ju do të keni të drejtën që të verifikoni nëse ne grumbullojmë të dhëna personale rreth jush dhe, nëse po, gjithashtu keni të drejtën t'i aksesoni këto të dhëna.

Nëse ju, si individ, dëshironi që të verifikoni nëse ne grumbullojmë të dhëna personale rreth jush, ju mund ta kërkonti këtë me shkrim përmes emailit (info@acs.si) ose postës së zakonshme.

E drejta për fshirje (“e drejta për t’u harruar”)

Ju do të keni të drejtën që të na kërkonti dhe ne të fshijmë të dhënat personale që lidhen me ju pa vonesa të paarsyeshme dhe ne do të kemi detyrimin si kontrollues t’i fshijmë të dhënat tuaja personale pa vonesa të paarsyeshme në rastet e mëposhtme:

- ju kundërshtoni përpunimin (shikoni të drejtën për të kundërshtuar);
- ne i kemi përpunuar të drejtat personale në mënyrë të paligjshme;
- ne duhet të fshijmë të dhënat personale për të qenë në pajtim me kërkesat e përcaktuara nga rregulloret.

Fshirja nuk do të kryhet nëse përpunimi i të dhënave personale kërkohet për qëllimet e mëposhtme:

- për plotësimin e një detyrimi ligjor për të përpunuar të dhënat bazuar te rregulloret;
- për qëllime të ngritjes, ushtrimit ose mbrojtjes së pretendimeve ligjore.

Nëse ju, si individ, dëshironi që ne të fshijmë të dhënat tuaja personale, ju mund ta kërkonti këtë me shkrim përmes emailit (info@acs.si) ose postës së zakonshme. Ju mund të ushtroni të drejtën e fshirjes vetëm në rastet e kufizuara të përcaktuara më lart.

E drejta për korrigjim

Ju do të keni të drejtën që të na kërkonti dhe ne të kryejmë korrigjimin e të dhënave tuaja personale të pasakta pa vonesa të paarsyeshme. Duke marrë në konsideratë qëllimet e përpunimit, ju do të keni të drejtën të plotësoni të dhënat personale të paplota, edhe përmes dhënies së një deklaratë suplementare.

Nëse ju, si individ, dëshironi që ne të korrigjojmë të dhënat tuaja personale, ju mund ta kërkonti këtë me shkrim përmes emailit (info@acs.si) ose postës së zakonshme.

E drejta për kufizimin e përpunimit

Ju do të keni të drejtën që të na kërkonti dhe ne të kufizojmë përpunimin e të dhënave tuaja personale në rastet e mëposhtme:

- nëse ju kontestoni saktësinë e të dhënave, për një periudhë që na jep mundësinë të verifikojmë saktësinë e të dhënave personale;
- përpunimi është i paligjshëm dhe ju kundërshtoni fshirjen e të dhënave personale dhe në vend të kësaj kërkonti kufizimin e përdorimit të tyre;
- neve nuk na nevojiten më të dhënat tuaja personale për qëllime përpunimi, por ato kërkohen prej jush për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore;
- ju keni kundërshtuar përpunimin në pritje të verifikimit nëse arsyet tona legjitime i anulojnë apo jo arsyet tuaja.

Nëse kërkonti kufizimin e arsyeve të lartpërmendura, ne mund të ruajmë vetëm të dhënat tuaja personale dhe të kryejmë të gjitha llojet e tjera të përpunimit vetëm:

- bazuar në miratimin tuaj;
- për ngritjen, ushtrimin ose mbrojtjen e pretendimeve ligjore;
- për mbrojtjen e të drejtave të një individi ose personi tjetër juridik; ose
- për arsye të interesit publik të rëndësishëm të Bashkimit Evropian ose të një Shteti Anëtar.

Përpara heqjes (pra, përfundimit) së kufizimit të përpunimit të të dhënave personale, ne do të jemi të detyruar t’ju njoftojmë për heqjen e kufizimit.

Nëse kemi refuzuar kërkesën tuaj për fshirjen e të dhënave ose nëse ju dëshironi vetëm të kufizoni përpunimin e të dhënave tuaja personale, ju mund të na kërkonti të kufizojmë përpunimin e të dhënave tuaja, të cilën ju mund ta bëni përmes emailit (info@acs.si) ose me shkrim përmes postës së zakonshme. Ju mund të ushtroni të drejtën e kufizimit të përpunimit vetëm në rastet e kufizuara të përcaktuara më lart.

E drejta e mbartjes

Ju do të keni të drejtën të transmetoni të dhënat që na keni komunikuar dhe që ne kemi grumbulluar gjatë përdorimit të shërbimit nga ana juaj. Ju mund t'i kërkonti të dhënat në formë portative personalisht pranë selisë sonë të regjistruar.

E drejta për të depozituar një ankesë pranë autoritetit kompetent mbikëqyrës

Pa cenuar zgjidhjet e tjera administrative ose ligjore, ju do të keni të drejtën të depozitoni një ankesë pranë autoritetit mbikëqyrës, në veçanti në Shtetin Anëtar të banimit tuaj të zakonshëm, vendit të punës ose vendit të shkeljes së pretenduar, nëse mendoni se përpunimi i të dhënave personale në lidhje me ju shkel Rregulloren e Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave.

Autoriteti mbikëqyrës pranë të cilit është depozituar ankesa do t'ju njoftojë rreth progresit dhe rezultatit të ankesës duke përfshirë mundësinë e një zgjidhjeje ligjore sipas Nenit 78 të Rregullores së Përgjithshme të Mbrojtjes së të Dhënave.

Si subjekt të dhënash, ju do të keni të drejtën të depozitoni një ankesë në adresën:

Republic of Slovenia, Information Commissioner, Zaloška 59, 1000 Ljubljana, Slovenia, telefon: 01 230 97 30, email: gp.ip@ip-rs.si.

Komisioneri i Informacionit do t'ju njoftojë në përputhje me rregulloret rreth progresit të çështjes dhe vendimit të tij rreth ankesës.

PUBLIKIMI NË UEBSAJT, POSTER, FLETËPALOSJE ETJ.

Për qëllime zhvillimi, shkencore dhe kërkimi si edhe për qëllime të raportimit te Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Sportit që është bashkë-financuese e aktiviteteve të **Qendrave të Mësimit Vetjak (QMV)** _____ (emri i qendrës, emri i organizatës suaj) duke mundësuar mbështetjen e studimit falas për mësim vetjak, ne do t'u kërkojmë pjesëmarrësve në QMV të japin disa të dhëna personale (emrin dhe mbiemrin, adresën e banimit, numrin e telefonit, gjininë, moshën, nivelin dhe llojin e arsimit të kryer, distancën e banesës sime nga QMV). Ne do t'ia kalojmë të dhënat personale për qëllime raportimi në një formë të tillë (formë të agreguar) që identiteti i pjesëmarrësit të QMV të mos jetë i dallueshëm prej tyre.

Një pjesëmarrës i QMV duhet të japë të dhënat personale nëse dëshiron të studiojë në ambientet e QMV. Përndryshe (nëse refuzon të japë të dhënat personale) ne nuk mund t'u japim mundësinë atyre të studiojnë në ambientet e QMV. Ne do t'i trajtojmë të dhënat e komunikuar në përputhje me legjislacionin slloven që drejton mbrojtjen e të dhënave personale dhe ligjin e Bashkimit Evropian.

Kontrolluesi i të dhënave personale është Instituti Slloven për Arsimin e Të rriturve që ofron gjithashtu mbështetje profesionale dhe zhvillimore për QMV. Të dhënat e agreguara i komunikohen gjithashtu Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Sportit për qëllime të përmbushjes së marrëveshjes së bashkë-financimit. Në përputhje me Ligjin e Mbrojtjes së të Dhënave Personale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë, Nr. 94/2007) dhe Rregullorja e Përgjithshme e Mbrojtjes së të Dhënave (Rregullorja (BE) 2016/679, OJ L 119, 4 maj 2016), Regjistri i Aktiviteteve të Përpunimit të të Dhënave të Pjesëmarrësit të QMV është aplikuar në _____ (emri i organizatës suaj) për qëllimin e sistemit të arkivimit për të dhënat personale të pjesëmarrësve të QMV në _____ (emri i organizatës suaj).

Ju mund të mësoni më shumë rreth përpunimit të të dhënave personale, politikës së mbrojtjes së të dhënave personale, periudhave të mbajtjes etj. në Deklaratën e Privatësisë të publikuar në uebsajtin: www.acs.si dhe që disponohet në ambientet e Institutit Slloven për Arsimin e Të rriturve.